



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.363/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Bujar Muzaqi – kryesues, Violeta Husaj Rugova, dhe Hajriz Hoti - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Refik Ramadani, kandidat për asamble komunale në Komunën e Gjilanit, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), të parashtruar kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN), në Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 31.10.2025, merr këtë :

V E N D I M

HEDHET E PASAFATSHME ankesa ZL.Anr.363/2025 datë 29.10.2025, e parashtruar nga Refik Ramadani, kandidat për asamble komunale në Komunën e Gjilanit, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), parashtruar kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN), në Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

PZAP-i më datë 29.10.2025, ka pranuar ankesën ZL.Anr.363/2025, e dorëzuar përmes postës me datë 24.10.2025, nga Refik Ramadani, kandidat për asamble komunale në Komunën e Gjilanit, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të parregullsive në Qendrën e Numërimit të Rezultateve (QNR), me të cilën pretendohet sa ka pasur parregullsi ashtu që fletëvotimeve ju është shtuar qëllimisht edhe një numër tjetër nga komisionarët, duke e bërë votën të pavlefshme. Parregullsitë janë evidentuar në vendvotimet 0423/02, 0416/03, 0413/02, 0425/02, 0425/01 dhe 0425/02. Në ankesë theksohet se këto veprime përbejnë ndërhyrje direkte në vullnetin e votuesit, me qëllim për të ulur numrin e votave të tij dhe kandidatëve të tjerë, dhe për të deformuar rezultatin zgjedhor. Kanë kërkuar nga PZAP nisjen e një hetimi të menjëhershëm për vendvotimet e lartpërmendura, auditimin, dhe rivlerësimin e të gjitha fletëvotimeve të shpallura të pavlefshme, zbulimin dhe ndëshkimin e personave përgjegjës, dhe përsëritjen të votimit në këto vendvotime.

Në përgjigje në ankesë të parashtruar me datë 30.10.2025, nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), ndër të tjera thuhet se bazuar në nenin 101 të LZP-së Nr.08/L-228, Rregulloren Zgjedhore Nr.16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), Procedura e veprimit në Qendrën Komunale të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e miratuar me

01.10.2025, Nr.01/2601/2025, përcaktohet procedura e detajuar lidhur me procesin e numërimit në QKN. Andaj bazuar në Rregulloren Zgjedhore Nr.13/2024 Rezultatet Zgjedhore, në nenin 9 paragrafi 1 thekson se në rastet të mospërputhjes së rezultateve, KQZ-ja mund të urdhëroj rinumërimin e votave të cili do VV, ose edhe përsëritjen e votimit në një VV apo QV. Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund të korrigjohen në Qendrën Komunale të Numërimit, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore Nr.16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit (QKN). Tutje, kanë theksuar se në lidhje me vlefshmërinë e fletëvotimeve, neni 16 paragrafi 2 i Rregullores Zgjedhore Nr.12/2024 Votimi, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit, përcakton se një votë është e vlefshme kur është shënuar vetëm një subjekt politik dhe kuptohet qartë vullneti i votuesit. Në të kundërtën vota konsiderohet e pavlefshme nëse: janë shënuar më shumë se një subjekt politik; nuk është shënuar asnjë subjekt politik; janë shënuar vetëm kandidatët, por jo subjekti politik; qëllimi i votuesit nuk është i qartë. Për më tepër, sipas nenit 16, paragrafi 6 të Rregullores Zgjedhore Nr.12/2024, nëse anëtarët e KVV nuk arrijnë të pajtohen lidhur me atë se a është vota e vlefshme apo e pavlefshme, atëherë kryesuesi merr vendimin përfundimtar përkitazi me atë votë dhe këtë rast e evidenton në librin e votimit.

Në përgjigje në ankesë kanë theksuar se ankesa është parashtruar pas afatit ligjor për paraqitjen e ankesës, pasi sipas konfirmimit të ZEKKZ-ve konstatohet se aktiviteti i QKN në Gjilan është përmbyllur me datë 18.10.2025, ndërsa pala ankuese, ankesën e ka parashtruar me postë me datë 24.10.2025, pra, ankesat nuk janë parashtruar brenda afatit ashtu siç parashihet me nenin 105, paragrafi 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Rezultatet përfundimtare të procesit zgjedhor, shpallen nga KQZ-ja pas përfundimit të numërimit të të gjitha fletëvotimeve nga vendvotimet e rregullta; fletëvotimet me kusht; fletëvotimet nga votimi i personave me nevoja të veçanta; fletëvotimeve nga votimet jashtë Kosovës; vendosjes për ankesat eventuale nga PZAP, dhe Gjykata Supreme dhe pas përfundimit të të gjitha procedurave në QNR, ku rezultati i publikuar është i ankimueshëm nga subjektet politike dhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numërimin e votave të tyre. Në momentin e publikimit të rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja, pala e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të LZP-së, mund të ushtroj ankesë në afatin brenda dyzet e tetë (48) orëve në PZAP. Tutje në përgjigje në ankesë kanë shtuar se KQZ ju njofton se i gjithë materiali zgjedhor, gjendet në QNR, dhe se i njëjti mund të verifikohet dhe hetohet nga PZAP, dhe organet e drejtësisë.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, gjeti se:

-Ankesa është e pasafatshme.

Në këtë rast, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, konstatohet se ankesa e parashtruar nga Refik Ramadani kandidat për asamble komunale në Komunën e Gjilanit, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), parashtruar kundër KQZ, ku ka pretenduar se ka pasur parregullsi në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) lidhur me manipulim të votave është parashtruar pas afatit të përcaktuar ligjor.

Në nenin 105 paragrafi 1, të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mënyrë decisive thuhet se *“Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR, dorëzohen me shkrim pranë PZAP-së brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar”*.

Në nenin 9 para. 5 të Rregullores nr. 01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, në mënyrë decisive thuhet se *“Personi mund të paraqes ankesë në PZAP, brenda dyzet e tetë (48) orëve për shkeljet e pretenduara”*, ndërsa në nën para. 5.16. të të njëjtës rregullore thuhet se *“Për shkeljet e pretenduara gjatë procesit të administrimit dhe numërimit në QKN dhe QNR”*.

Në nenin 13, para. 3, nën para. 3.2 të Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, në mënyrë decisive thuhet që: *“PZAP-i e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor.”*

Në rastin konkret Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës ka dorëzuar ankesën përmes postës me datë 24.10.2025, ndërsa në PZAP e njëjta ankesë është pranuar me datë 29.10.2025, ndërsa nga të dhënat zyrtare, e po ashtu edhe nga përgjigja e KQZ-së është vërtetuar me konfirmimin e ZEKKZ në Komunën e Gjilanit, se aktiviteti i QKN-së është përmbyllur me datë 18.10.2025, me çka vërtetohet se ankesa e ankuesit nuk është parashtruar brenda afatit ligjor prej 48 orëve, siç rregullohet me nenin 105, paragrafi 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, andaj dhe ankesa hedhet si e pasafatshme.

Nga të lart dhe duke u bazuar nenin 105 paragraf 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, lidhur me nenin 9 paragrafi 5 nën paragrafi 5.16, nenit 13, paragrafi 2, neni 13 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 të Rregullës 01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.363/2025 më datën 30.10.2025

**Kryesues i Panelit,
Bujar Muzaqi**



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.